



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

Të mbledhjes së parë të Komitetit Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara, mbajtur më 15.03.2022, e cila filloi në orën 13:30.

Në mbledhje morën pjesë: Fatime Demolli - Mustafa, kryesuese, dhe anëtarët e komitetit: Ramadan Salihu, Mehreme Llumnica, Jeton Canhasi dhe Gyltene Retkoceri.

Munguan: Armend Ademi, Ermira Shabani.

Në mbledhje ishin të pranishëm: Premtime Preniqi, koordinatorë për të drejtat e njeriut, Adelina Sahiti, drejtoreshë e Drejtorisë së Mirëqenies Sociale, Bujar Gashi, drejtor i Drejtorisë në Qendrën e Mjekësisë Familjare, Ilirik Musliu, drejtor i drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit, Habib Qorri, zyrtarë i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Irfete Zejneli përfaqësuese i Drejtorisë së Investimeve Kapitale, Albulena Ahmeti, zyrtarë e DKA-së. Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Fatime Demolli-Mustafa, me këtë

REND TË DITËS:

- 1. Miratimi i ekstrakteve të procesverbaleve të mbledhjes së gjashtë dhe të shtatë të Komitetit Konsultativ të Personave me Aftësi të Kufizuara;**
- 2. Plani i veprimit për personat me aftësi të kufizuara në komunën e Prishtinës 2021-2022;**
- 3. Raport mbi monitorimin e Planit të veprimit për personat me aftësi të kufizuara në komunën e Prishtinës - dhjetor 2020 ;**
- 4. Të ndryshme.**

Fatime Demolli - Mustafa, kryesuese, i përshëndeti dhe i falënderoi të pranishmit për pjesëmarrje, nënkryetarin e Komunës, z. Alban Zogaj, drejtorët e drejtorive që janë pjesëmarrës dhe anëtarët e Komitetit.

Komiteti i KPAK-së në Prishtinë është në mandatin e dytë të funksionimit, përkundër kompetencave vetëm konsultative, është përballur me kërkesat e shumta nga komuniteti i personave me aftësi të kufizuara për zgjidhjen e problemeve të ndryshme komunitare, me gjithë rezultateve e deritanishme, kundër përkushtimit dhe vullnetit për shqetësimet e komunitareve, shumë çështje kanë mbetur pa përgjigje, që janë të suplimuara në dokumentin

e PV-së, të cilin e keni para vetes, Planin e veprimit për PAK, 2018-2021, i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës në tetor të vitit 2018, i cili është dokument publik dhe me një rëndësi të veçantë për komunitetin, i cili përshkruan konceptet se si Komuna do t'i qaset diversitetit dhe gjithë përfshirjes, si dhe specifikon synimet dhe planet e saj për të eliminuar diskriminimin e kësaj kategorie të qytetarëve.

Komiteti ka monitoruar zbatimin e këtij plani në periudhën trevjeçare, ku nga analiza rrjedh se prej 36 pikave të renditura për monitorim:

- Tërësisht janë realizuar nëntë (9) sosh, apo (25%);
- Pjesërisht janë realizuar trembëdhjetë (13) sosh, apo (36.11%); si dhe
- Nuk janë realizuar katërbëdhjetë (14) sosh, apo (38.88%).

Megjithatë, ajo që mbetet ende sfida kryesore për t'u jetësuar është pika e parë e planit, përkatësisht arritja e kuotës së punësimit, e që është 1 person me aftësi të kufizuar në 50 punëtorë të punësuar, d.m.th. 2% e të gjithë të punësuarve.

Në qershor të këtij viti, Komuna e Prishtinës, në bashkëpunim me Komitetin, ka hartuar dhe miratuar Planin e veprimit për persona me aftësi të kufizuara, 2021-2023, ku presim të jetë në përqindje më të madh.

Prej të gjitha pikave të raportimeve që vijnë në Komitet nga Plani i veprimit, e ajo që më së shumti e preokupon personin me aftësi të kufizuar është punësimi, i cili ende ngec.

Mbi bazën e të dhënave nga monitorimi i Planit të veprimit në Komunën e Prishtinës, vetëm në domenin e punësimit, rezulton se prej 4.398 të punësuarve, 13 të punësuar janë PAK, apo, shprehur në përqindje, vetëm 0.36%. Po ashtu, aktualisht është bërë problem edhe parkingu i veturave të PAK, ku këta persona sipas PV-së, janë të liruar nga pagesa, mirëpo "Prishtina Parking" nuk e lejon një parking të tillë pa pagesë, e që ka paraqitur një problem të madh.

Përveç dy PV për PAK, ekzistojnë edhe 3 ligje për PAK, dispozita firmative nëpër ligje përkatëse, një mori udhëzimesh administrative, Strategjia nacionale për të drejtat e PAK, si dhe Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për shpalljen e vitit 2022 vit i PAK-së dhe Vendimi i Kryeministrit të Republikës së Kosovës për punësimin e PAK-së. Pa minimizuar mbështetjen sociale ligjore të aftësisë së kufizuar, arsimimin, punësimin e PAK-së, sjell deri te integrimi i tyre në shoqëri, të cilin integrim duhet, dhe pres që së bashku do ta arrijmë me pjesëmarrësit e mandatit të ri që e kanë marrë dhe ju uroj që bashkërisht t'i shtyjmë të gjitha gjërat përpara që i kemi në PV. Po ashtu, e falënderoj zyrtaren për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe barazi gjinore, znj. Premtime Preniqi, e cila ka qenë përkrahëse që nga themelimi i KKPAK-së.

Alban Zogaj theksoi se ky KKPAK-ra ka shumë rëndësi për mua, dhe do të jem në vazhdimësi i interesuar për mbështetjen tuaj për me parë një PV të mirë, e jo vetëm një plan që shkruhet dhe na mbetet në tavolinë, në sinitar, por një plan që zbatohet. Këtu i kemi problemet zakonisht si shoqëri, sepse po shkruajmë plane të mira, por në anën tjetër pastaj mbesin në implementim të tyre. Unë ju përgëzoj për punën e juaj dhe çdoherë do të jem në mbështetjen tuaj.

Keni përshëndetje edhe nga kryetari Rama. Desha ta potencoj se në planin e kryetarit Rama, po edhe në planin të cilin ai e ka fituar mandatin e tij me udhëhequr, PAK do ta ketë një vëmendje të veçantë.

Gjatë fushatës tonë politike 6 mujore kemi takuar shumë organizata, por edhe individë të cilët i kanë shprehur shqetësimet e tyre në vazhdimësi. Këta anëtarë janë anëtarë të shoqërisë sonë, në çdo takim që e kemi shprehin një shqetësim të përgjithshëm, të jemi të barabartë me të gjithë të tjerët, të kemi qasje të barabarta në të gjitha sferat e jetës nga qasja në rrugë, në mobilitet, e nga hyrja në ndërtesa deri tek një prej të drejtave bazike të çdo individi, e qasje më shumë të këtyre grupeve, si qasja në punësim, për të punuar si të tjerët, për t'u socializuar, për ta zhvilluar veten dhe për ta zhvillu shoqërinë. Prandaj edhe ne si institucion publik, por edhe si shoqëri duhet të ndihmojmë në çdo formë dhe me dhënë shembuj të mirë, e pastaj sektori privat si duhet të hapin dyert për punësim. E para ne i krijojmë kushtet që puna të bëhet në kushte të mira të punës.

Unë e di se jemi shumë keq, i lexova disa statistika, këto statistika janë për keqardhje dhe jemi larg për me mbërritur këtë qëllimin që e kemi 2% e totalit të të punësuarave, se rreth Komunës së Prishtinës, sot rreth nesh punojnë 5 mijë persona, po thuaj 1 mijë vetëm në administratën e Komunës së Prishtinës, e 2% pastaj i këtij 5 mishit është shifër relativisht e lartë të cilën kemi me pasur vështirë me arritur shumë shpejt, por duhet të fillojmë urgjent me punuar në atë drejtim. Me planin dhe agjendën tonë dhe programin e kryetarit Rama, ne i kemi parasysh barrierat aktuale në qytetin e Prishtinës, sa i përket këtyre personave që unë gjithmonë i quaj, anëtarë të familjes sonë. Këto barrierat duhet të fillojmë gradualisht t'i eliminojmë, duke filluar prej qasjes në rrugë, qasjes në ndërtesa, deri te punësimi, dhe atë që duhet ne të japim për këta anëtarë të familjes është barazia dhe lufta ndaj diskriminimit duhet të jetë një prej vlerave tona fundamentale. Unë insistojmë shumë që në çdo takim, çdo konkurs, në çdo formë që ne e kemi mundësinë me dhënë kontributin tonë në këtë drejtim.

Fatime Demolli - Mustafa e falënderoi nënkryetarin dhe e përgëzoi, që të jetë miratues për PV dhe zbatues në të gjitha drejtoritë komunale, të cilat i kemi sot këtu prezent dhe në takimet e radhës ne t'i tregojmë ato përqindjet më të larta të cilat i dëshirojmë.

Albulena Ahmeti përfaqësuese e DKA-së, tha se po lidhet me pikat të cilat i takojnë DKA-së, te regjistrimi i fëmijëve me AK. Sipas raportit, ne i kemi të dhënat që i marrim prej institucioneve arsimore, por nuk e kemi një data-bazë të saktë për fëmijët që janë jashtë institucioneve arsimore. Na duhet një bashkëpunim me Drejtorinë e Shëndetësisë, të Mirëqenies Sociale, që bashkërisht me krijuar një data-bazë, ku mund të përfshihen të dhënat e secilit fëmijë.

Sa i përket pikës së vlerësimit, vlerësimi bëhet me vonesë. Është e vërtetë, në mungesë të zyrtarit të gjithëpërfshirjes në DA, që ka qenë një zyrtar që ka kryer dy funksione, dhe kjo ka ndikuar në vlerësimin numër të vogël të fëmijëve me aftësi të kufizuara, mirëpo tani me ardhjen e z. Lulëzim Vrapca është rritur numri i vlerësimeve. Tani çdo javë nga tri vlerësime realizohen dhe në të ardhmen kjo s'ka me qenë me vonesë.

Po ashtu, është insistuar personeli për mësues mbështetës, në vitin e kaluar i kemi 12 mësues mbështetës që janë punësuar në DKA të Prishtinës. Kjo lidhet pak a shumë me PV-në, që e kemi paraparë me u rritur numri i vlerësimit, ose me i monitorua. Gjatë këtij viti pritet me u hapur konkursi edhe për 15 asistentë për PAK. Jo që i plotësojnë nevojat, se në Komunën e Prishtinës i ka më se 500 fëmijë me nevoja të veçanta, ku shumica kanë nevojë për një asistent. Sa i përket infrastrukturës që e kemi bërë në PV, e vërtetë ne ngecim komplet, jo vetëm ne, por

në gjithë vendin tonë kemi problematika, sepse shumica e shkollave janë të vjetra dhe nuk ka pas gjithëpërfshirje dhe nuk e kanë pasur statusin e duhur. Po ashtu, ceku se për herë të parë në Komunën e Prishtinës këtë vit është realizuar, në kuadër të DKA -së, shënimi i Ditës për Personat Përdorues të Karrocave.

Fatime Demolli Mustafa tha te PV te lista dua me diskutuar çështjen e sigurimit të transportit për edukimin dhe arsimin e nxënësve me nevoja të veçanta, sa kam unë dijeni DKA-ja ja paguan transportin vetëm nxënësve, mirëpo në PV është që transportin ta bëj edhe për fëmijët të cilët i vijojnë institucionet parashkollore andaj si Komitet kërkojmë nga ju të bënë një kërkesë te kryetari zotëri Rama ta ndryshoj Vendimin paraprak që është vetëm nxënësit kështu që në Vendimin e ri ti potencon edhe fëmijët që vijojnë institucionin parashkollore.

Albulena Ahmeti tha vetëm Komuna e Prishtinës e ka një Vendim të tillë që nuk është e potencuar fëmija në institucionin parashkollor, do ta diskutoj dhe e bëjë një kërkesë se ka nevojë shumë edhe për kopshte.

Premtime Preniqi tha si komitet dhe unë si koordinatorë e të drejtave të njeriut kemi pasur shumë ankesa lidhur me nënat në kopsht, arsyeja se kopshtet zakonisht preferohet me qenë kopshti më i afërt që fëmija e ka në lagje ne vitin e kaluar e kemi pasur një rast kopshti i cili ndoshta ka qenë dy minuta nuk e ka pranuar fëmijën, ndërsa nëna është dashur dy herë të bëjë transport me shkuar te kopshti konkretë, ne si Komitet edhe unë si zyrtarë kemi pasur takime dy tri here me atë kryesi të atij kopshti dhe nuk kemi arritur qëllimin dhe aj fëmijë ka qenë një vjeçar dhe në fund edhe mos me ju paguar edhe me kushte sociale ka qenë.

Albulena Ahmeti pyeti cili kopsht është ai.

Premtime Preniqi dha sqarime.

Albulena Ahmeti tha për rastin konkrete janë në bazë me komunitet dhe menaxhohen nga komuniteti dhe ata i marrin vendimet na si DKA nuk kemi të drejt.

Adelina Sahiti, drejtoreshë e Mirëqenies Sociale tha është shumë e rëndësishme të kemi një shoqëri ku gjithë të trajtohen në mënyrë të barabartë në veçanti kur kemi të bëjmë me PAK -ra, të kenë trajtimin siç duhet.

Unë sa kam parë në drejtorinë e Mirëqenies Sociale në mandatin e kaluar është punuar punua jashtëzakonisht shumë në infrastrukturë për t'ju ndihmuar OJQ-re të ndryshme, shoqatave që merren me të gjithë PAK, që ju ofrojnë shërbime për këta persona dhe që në të njëjtën kohë na ndihmojnë neve si Komunë na lehtësojnë punën që të kemi qasje të drejtpërdrejte tek PAK -ra, dera jonë do të jetë e hapur jo vetëm në kuptimin e dëgjimit të ankesave por ato të adresohen që vërtetë në fund të marrin një trajtim meritore.

Fatime Demolli Mustafa tha duhet të jetë përgjegjësi e Drejtorisë së Mirëqenies Sociale, ne kemi paraparë që në vitin 2022 të ndërtohen 2 objekte për qëndrim ditor për PAK -ra, ju si drejtori si e keni paraparë sa mundet me qenë e realizueshme në të ardhmen.

Adelina Sahiti dha sqarime.

Bujar Gashi i përshëndeti të pranishmit dha sa i përket pikës tre dhe pestë që i preferohet drejtorisë së shëndetësisë kjo pika tre përkrahja e OJQ-ve që merren me PAK -ra ka qenë në kuadër të drejtorisë Mirëqenies Sociale për shkak të buxhetit më të madh dhe besoj kanë qenë të mbështetur nga kjo drejtori tu marrë parasysh se DSH -së e ka pasur një buxhet solid të subvencioneve dhe ka qenë e orientuar në vetëm dhënien e subvencioneve qytetarëve që kanë probleme shëndetësore.

Ndërsa te kontraktimet e shërbimeve d.m.th. te pika e pestë kontraktimet e shërbimet e OJQ-ve do të ishin të mirëseardhura disa prej shërbimeve ndoshta që i kemi me mungesë së bashku me drejtorin Izet i kemi rritur orarin e shërbimit kronik i cili merret me pacientët me sëmundje terminale ose probleme kronike.

Në monitorimi që është bërë në vitin 2020 ky monitorim në pikat monitoruese i pash disa prej pikave sigurimi i lokaleve OJQ-re e dini qendra e autizimit është në QMF-re 8.

Sa i përket vaksinimit kundër COVID -19 dhe qytetarët dhe PAK -ra e kanë pasur mundësin, e kemi ekipin mobile të cilët e kanë bërë vaksinimin e qytetarëve në shtëpi.

Po ashtu informoi se do të organizohen ekipe të posaçme psikologësh dhe psikoterapi tu marrë parasysh në bazë të Udhëzimit administrativë 0.4/2020 për kujdesin parësor shëndetësor psikologët nuk janë pjesë e këtij Udhëzimi dhe e kemi problemi punësimin e psikologëve dhe lëmenjve tjerë se në Udhëzim parashihen vetëm mjeku familjar, infermierët, stomatologu, radiologu.

Sa i përket kuotës ose përqindjes PAK -ra në kuadër të kujdesit parësor shëndetësor është 5 prej 871 sa është numri total bashkë me DSH në Komunën e Prishtinës.

Fatime Demolli - Mustafa tha sa i përket trajnimit të stafit mjekësor nëse e kemi në mandatin e juaj ju kisha sugjeruar të kontaktoni me KKKPAK -ra i cili është mjaft i përgatitur dhe është profesional brenda Komitetit kemi mjek, jurist, psikolog të gjithë janë të kualifikuar janë me master nëse e shihni të nevojshme që këta pjesëtar të jenë trajner për çështje të caktuara jemi të mirë se ardhur

Irfete Zejneli përfaqësuese nga drejtoria e Investimeve Kapitale, tha se ka qenë pjesë e këtij PV dhe jemi munduar me punuar, pikat të cilat i takojnë drejtorisë sonë, adaptimi i trotuareve për lëvizje e personave me karroca dhe nënave që kanë fëmijë, qasja në objekte publike dhe ato private të qasshme për PAK dhe ndërtimi i tualeteve publike, ku PAK kanë qasje me kartelë, ku për këto pika në bazë të kërkesave që janë paraqit nga "Hendikos", vetë qytetarëve ose familjarëve të PAK prej vitit 2017-2018, thuaje çdo herë që është bërë planifikimi i buxhetit, u kemi përcjellë, por me shumë keqardhje, asnjë herë nuk është paraparë me u ndarë ndonjë buxhet për këto pika as në vitin 2022, mirëpo me ardhjen e drejtorit të ri menjëherë ju kemi përkujtuar të paktën me hi në planin investiv për vitin 2023.

Fatime Demolli - Mustafa e falënderoi zyrtaren Irfete për kontributin e dhënë në PV.

Ilirik Musliu tha si drejtori ne brenda PV-së i kemi pesë pika, te pika e nëntë, që është hapësira për këmbësorë-adaptimi dhe lirimi i trotuareve për lëvizje me karrocë në tërë qytetin, ne si drejtori jemi duke punuar për Planin e mobilitetit, i cili i analizon problemet për këmbësorë dhe për PAK, që duhet fuqi dhe një plan i detajuar me bërë një zgjidhje të përhershme.

Pikë tjetër është sinjalistika, ku ne si drejtoria e kemi një projekt brenda këtij viti, që besoj prej prillit veç ka me qenë në implementim. Me projektin e ri do ta ketë një gjithë përfshirje të nyjave dhe semaforëve.

Pikë tjetër është vetëparkingu i dedikuar për PAK dhe pa pagesë. Kemi pasur takim me drejtorin ekzekutiv të "Prishtina Parking", po presim me na dërguar një draft e pastaj me u konsultuar.

Pikë tjetër e kemi numrat dhe emërtimet e linjave të autobusëve urbanë të zmadhohen dhe të bëhen me zë, "Trafiku Urban" këtë shërbim e ka, jemi duke punuar me GIZ-në gjerman. Kjo

është duke u trajtuar dhe kemi me dalë me formatin e ri të linjave të autobusëve, në këtë rast edhe për PV të përmbushim një pikë.

Pikë tjetër është lirimi i PAK-së dhe shoqëruesit nga tarifa e transportit publik dhe privat, jemi duke punuar me një pako, që kanë me u përfshirë të gjitha këto çështje.

Fatime Demolli - Mustafa tha se Komiteti në javët e fundit është me zyrtarin Habib Qorri. Sa i përket "Prishtina Parkingut" ne kemi qenë, kemi biseduar, na është thënë nëse ju drejtorja juaj jepni një vendim, atëherë ata do t'i lirojnë nga pagesa.

Premtime Preniqi, si koordinatorë për të drejtat e njeriut, ku bëjnë pjesë edhe të drejtat e PAK-së, tha se që në fillim jemi përballur me probleme, duke nisur prej infrastrukturës, e cila nuk ka qenë e përshtatshme. Pra mundemi me thënë se PAK është kategoria më e diskriminuar, duke u nisur prej infrastrukturës, qasjes në arsim, shëndetësi deri te punësimi. Komuna e Prishtinës ka pasur çdo vit ndryshime, çështja kryesore ka qenë qasja në hyrje të Komunës së Prishtinës, ku janë bërë dy ashensorë. Kemi disa pjerrina në qytet, nëpër QMF janë ndërtuar disa ashensorë, janë bërë pjerrinat, gjithashtu është bërë tualeti për PAK. Nuk është se është punuar shumë për PAK. Edhe kur po punohet, nuk po punohet sipas standardeve. Janë punuar zebat në vende të ndryshme të qytetit të Prishtinës nuk janë siç duhet, ne si Komitet dhe unë si zyrtarë, kemi reaguar për t'i përmirësuar këto. Në disa vende kemi hasur në mirëkuptim e janë rregulluar disa vende kanë mbetur ashtu.

Ne si shoqëri, në qoftë se në çdo hap ku PAK nuk mund të kalojë një hap tutje, ne si shoqëri shkojmë dy hapa mbrapa.

Mehreme Llumnica tha se Komiteti është funksional, është iniciativë shumë e mirë ekzistenca e PV-së, që ka qenë initiative e OJQ "Hendikos" dhe ish-kryetarit Shpend Ahmetit, që e ka themeluar një grup punues të rregullt prej dikastereve thuaj kyçe, për hartimin e grupit punues dhe përfaqësuesit e të gjitha llojeve të aftësive të kufizuar. E kemi një përparim, se hapat konkret janë marrë sidomos në gjithëpërfshirje, e mos të flasim për vitin e kaluar, ku DMS ka punuar shumë dhe DSH me vetë faktin që edhe në komisione për subvencione ka pasur përfaqësues nga PAK, kanë qenë edhe në verifikimin e strehimit të banimit kolektiv, janë bërë edhe pjerrina, qasje me ashensorë dhe disa tualete. Po ashtu, "Trafiku Urban" i ka liruar PAK nga pagesa dhe ka hapur konkurs për PAK, në bashkëpunim me OJQ. Edhe DSH me prioritet i ka përzgjedhur me kushte të barabarta dhe kualifikime. Te shëndetësia është bërë një përparim, por shumë i rëndësishëm është edhe inkuadrimi i psikologëve.

Gyltene Retkoceri theksoi se në disa komuna, si në Ferizaj dhe Gjiilan, kanë psikologë.

Bujar Gashi dha sqarime.

Albulena Ahmeti dha sqarime, duke thënë se në çdo javë bëhen nga tri vlerësime dhe jemi duke e bërë monitorimin nëpër shkolla. Përveç vlerësimit, japin edhe rekomandime, ku askund në Udhëzimi administrativ nuk është cekur se duhet të bëhet monitorimi, por ide është që puna me u kryer si duhet.

Mehreme Llumnica tha se gjithmonë ka qenë, nëpër shkolla janë ardhur.

Mbledhja përfundoi në orën 14:40.

Procesmbajtësja:
Shyhrete Islami

Kryesuesja e Komitetit
Fatime Demolli - Mustafa

Faqe 6 nga 6

